



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 26.6.2023

Nr: 675

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 398 ID, 399 ID, 400 ID, 401 ID, 440 ID, 441 ID, NGA KOALICIONI PËR REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË KONSOLIDUARA NDAJ PERSONAVE PËRGJEGJËS, PËR RAPORTIMIN E VEPRIMTARIVE PUBLIKE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot më datë 26 Qershor 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjet administrative me:

- KËRKUES:** Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)
- SUBEKT:** Z. Ditmir Kraja, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Shkodër;
Zj. Xheni Kitaj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Korçë;
Z. Reinis Çela, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Lezhë;
Zj. Alma Dervishi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
Zj. Delina Hoxha, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Roskovec;
- OBJEKT:** Shqyrtim administrativ ndaj personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike
- BAZA LIGJORE:** Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së

Data: 26.6.2023

Nr: 675
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 398 ID, 399 ID, 400 ID, 401 ID 440 ID, 441 ID, për shkelje administrative”

Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Nga organizata Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) janë depozituar, indicie për organizimin e 5 (pesë) veprimtarive publike, nga 5 (pesë) institucione publike, për të cilat pretendohet se nuk janë raportuar në ndërfaqen e dedikuar për këtë qëllim. Indiciet janë marrë nëpërmjet provave link, të administruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Denoncimet janë marrë nëpërmjet provave link dhe materialeve fotografike, të administruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet raportit XVI të KRIIK, të datës 8 Maj 2023, “Për gjetjet dhe rekomandimet për javën 28 Prill – 4 Maj 2023” dhe raportit XVII të KRIIK për periudhën 4 - 14 Maj 2023, lidhur me raportimet dhe veprimtaritë me karakter publik të institucioneve, lidhur me raportimet dhe veprimtaritë me karakter publik të institucioneve.

Neni 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, u shqyrtua paraprakisht çështja dhe u vlerësua se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për t’u nisur hetimi administrativ.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundrvajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Meqenëse në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë paraqitur disa denoncime nëpërmjet provave link dhe objekti i shqyrtimit bazohet në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore, në mbështetje të nenit 65, shkronja “ç” të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, u vendos shqyrtimi së bashku i këtyre indicieve.

Në vijim të procedurës administrative, filloi hetimi administrativ, duke kërkuar informacion në lidhje me veprimtaritë publike të paraportuar në ndërfaqe.

Data: 26.6.2023

Nr: 675
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 398 ID, 399 ID, 400 ID, 401 ID, 440 ID, 441 ID për shkelje administrative”

Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka kërkuar nga institucionet publike nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljeve të pretenduara.

Subjektet objekt i këtij vendimi kanë paraqitur pretendime si më poshtë vijon:

- 1. Denoncimi regjistruar me nr. 398 ID dhe nr. 441 ID ndaj bashkisë Shkodër**, me kërkues KRIIK, ku pretendohet si më poshtë vijon:
 - **Denoncimi nr. 398 ID:** *“Kryetari i Bashkisë Shkodër z.Bardh Spahia priti në një takim të veçantë në zyrën e tij nxënësit e klasës së katërt të medresesë “Haxhi Sheh Shamia”. Nën drejtimin e mësueses Blerta Troshani ata u njohën me punën e institucionit të Bashkisë Shkodër. z. Spahia përgëzoi stafin pedagogjik dhe drejtuesit e medresesë për punën dhe kontributin që japin në edukimin e brezit të ri.*

Prova link:

<https://www.facebook.com/bashkiashkodres/posts/pfbid02zyPys287nE6HsJ9idTzk2a97AepPq87hFi8hnywPeJUax911TtëfA1SbKng145cDI>

Theksohet se ky aktivitet nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator.”

Denoncimi nr. 441 ID: *“Kryetari i Bashkisë Shkodër z.Bardh Spahia priti në një takim të veçantë në zyrën e tij nxënësit e klasës së katërt të medresesë “Haxhi Sheh Shamia”. Nën drejtimin e mësueses Blerta Troshani ata u njohën me punën e institucionit të Bashkisë Shkodër. z. Spahia përgëzoi stafin pedagogjik dhe drejtuesit e medresesë për punën dhe kontributin që japin në edukimin e brezit të ri.*

Prova link:

<https://www.facebook.com/bashkiashkodres/posts/pfbid03173VqP9qy4auRx97qc533YRxiQfC7fznATCU2frpDuHaxxNDHa2nE7EedUYxZzXI>

Theksohet se ky aktivitet nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator.”

Më datë 11 dhe 18 Maj 2023, bashkisë Shkodër, i është kërkuar informacion në lidhje me dy indiciet e marra nga denoncimet nr. 398 ID dhe 441 ID, nëpërmjet adresës elektronike, ku jemi informuar se: *“Takimi i datës 05 Maj 2023 me nxënësit e shkollës “Haxhi Sheh Shamia” ka qënë një takim spontan dhe jo i programuar ose organizuar, nxënësit e kësaj shkolle kishin një tur informues në lidhje me funksionimin dhe shërbimet që bashkia Shkodër ju ofron qytetarëve, në kuadrin e orës mesimore të lëndës Qytetari.*

Të gjendur në këto kushte mësuesja e lëndës pas një takimi të rastësishëm me kryetarin e Bashkisë Shkodër, kërkoi një takim të shkurtër në zyrë me nxënësit e shkollës, gjë që u mirëprit nga ana e kryetarit z. Bardh Spahia. Prandaj nisur nga kjo sqarojmë edhe njëherë që ky takim nuk ishte i programuar dhe nuk kishte asnjë sfond politik.

Sa më sipër takimi është realizuar mbi bazën e komunikimit verbal.”

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 11.5.2023, ora 12:00, ku u ftuan në këtë proces, duke u dhënë të drejtën për t’u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt denoncimi nr. 398 ID, por nuk u paraqitën në këtë seancë.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ për denoncimin e regjistruara me nr. **398 ID, dhe nr. 441 ID** pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të tyre, provohet se nisur nga tematika dhe natyra e aktivitetit, është vlerësuar se veprimtaria e kryer nga subjekti i denoncuar nuk përbën veprimtari publike në kuptim të pikës 1, të nenit 92 të Kodit Zgjedhor.

Referuar nenit 92, pika 1 e Kodit Zgjedhor *“Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre”.*

Pjesëmarrja e nxënësve të shkollës “Haxhi Sheh Shamia”, në kuadrin e orës mesimore në një aktivitet me dyer të mbyllura, nuk e bën aktivitetin publik nga natyra, pasi kryetari i bashkisë në këtë rast është në përmbushje të detyrave të veta funksionale.

Përsa më sipër, në kushtet ku referuar elementeve të këtij aktivitetit , subjekti bashkia Shkodër nuk ka patur detyrimin e raportimit të këtij aktiviteti në kuptim të nenit nenit 92 të Kodit Zgjedhor, vlerësohet se duhet të pushohet shqyrtimi administrativ.

2. Denoncimi regjistruar me nr. 399 ID ndaj bashkisë Korçë, me kërkues KRIIK, ku pretendohet si më poshtë vijon:

- **Denoncimi nr. 399 ID:** *“Melçan - Në Melçan do të zgjidhet përfundimisht problemi i kanalizimeve të ujërave të ndotura.*

Inspektuam punimet për ndërtimin e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura, ku njëkohësisht do të ndërtohet edhe një mini impiant për trajtimin e tyre njësoj si qyteti. Çdo ditë me punë e projekte të mëdha në çdo fshat të Bashkisë Korçë.

Data: 26.6.2023

Nr: 675

Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 398 ID, 399 ID, 400 ID, 401 ID, 440 ID, 441 ID për shkelje administrative”

#VetëmPërpara #KurrëMëMbrapa

Prova link:

<https://www.facebook.com/filosotiraa/posts/pfbid02q1TSdGRh1iTVkNJotjocdcvraqHbXBYYKaējuoDE4ZEy7GV8cAb4GbocaWsf4tQwyl>

Theksohet se ky aktivitet nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator."

Më datë 8.5.2023, bashkisë Korçë, i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike, ku jemi informuar se: *"Kjo veprimtari nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së pasi është zhvilluar në kuadër të fushatës elektorale. Gjithashtu, ajo nuk është pasqyruar në faqet zyrtare në rrjetet sociale të bashkisë Korçë dhe në fund të postimit të publikuar është përdorur me hashtag slogani i Partisë Socialiste për fushatën e zgjedhjeve vendore."*

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 11.5.2023, ora 12:00, ku u ftuan në këtë proces, duke u dhënë të drejtën për t'u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, por nuk u paraqitën në këtë seancë.

Në përfundim të hetimit administrativ, pas shqyrtimit të materialeve u vlerësua se natyra e aktivitetit të kryer në denoncimin nr. 399 ID nga kryetari i bashkisë Korçë është i karakterit politik dhe nuk është veprimtari publike e institucionit të bashkisë. Aktiviteti është zhvilluar në kuadër të veprimtarive politike, fakt ky që provohet nga përmbajtja e sloganeve në postimin e bërë nga kryetari i bashkisë. Kryetari i bashkisë, si funksionar i partisë ku aderon, mund të jetë pjesëmarrës në aktivitete dhe të shprehë mendimet e veta.

Këto veprimtari nuk kanë detyrimin për raportim në ndërfaqen e raportimeve pasi nuk janë zhvilluar në cilësinë e funksionarit publik, atë të kryetarit të bashkisë. Përsa më sipër, rezultoi se veprimtaria objekt denoncimi për bashkinë Korçë nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në nenin 92 të Kodit Zgjedhor si dhe të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Referuar denoncimit nr. 399 ID në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezultoi për shkak të tematikës dhe natyrës, aktivitetet e mësipërme nuk futen në kategorinë e veprimtarive të cilat kanë detyrimin për raportim në kuptim të nenit 92 të Kodit Zgjedhor. Në këto kushte, vlerësoj se duhet të pushohet shqyrtimi administrativ, sepse objekti rast denoncimi nuk përmban rrethana që mund të përfshihen në parashikimet e nenit 92 të Kodit Zgjedhor.

Data: 26.6.2023

Nr: 675

Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 398 ID, 399 ID, 400 ID, 401 ID, 440 ID, 441 ID për shkelje administrative"

3. Denoncimi regjistruar me nr. 400 ID ndaj bashkisë Lezhë, me kërkues KRIIK, ku pretendohet si më poshtë vijon:

- **Denoncimi nr. 400 ID:** *“Në tryezë me arkitektë & inxhinierë, ku i falënderova për punën e palodhshme që secili prej tyre bëri në procesin e rindërtimit të Lezhës. Proçes në të cilin, ky target mbajti peshën më të rëndë. Diskutuam për Lezhën sot dhe nesër; planin urban, rrjetin rrugor, projektet e reja të mëdha dhe të vogla të cilat do vazhdojmë t’i bëjmë bashkë. Folëm edhe për ngjyrat që aktualisht ka marr qyteti, dhe se projektet në fasada, efijçencë energjetikë dhe restaurime nuk do ndalojnë deri në pallatin e fundit të Bashkisë Lezhë. Punët e mira bëhen me profesionistë të mirë, ndaj ja kemi dalë.*

Falënderit!

Prova link:

https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid02DX4ixcpcëmëhuSU1GUQTscFrs8zLcACvËhTd62MRNjXkmËrBsCzk5LA27eSpmËrpl&id=100009765763688

Theksohet se ky aktivitet nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator.”

Më datë 8.5.2023, bashkisë Lezhë, i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike, por institucioni nuk i është përgjigjur kërkesës.

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 11.5.2023, ora 12:00, ku u ftuan në këtë proces, duke u dhënë të drejtën për t’u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, por nuk u paraqitën në këtë seancë.

Në përfundim të hetimit administrativ, pasi shqyrtova të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, vlerësoj se për të dhënat që disponohen, të nisur nga tematika dhe natyra e aktivitetit, është vlerësuar se veprimtaritë e kryera nga subjekti i denoncuar nuk përbëjnë veprimtari publike në kuptim të pikës 1, të nenit 92 të Kodit Zgjedhor.

Referuar nenit 92, pika 1 e Kodit Zgjedhor *“Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre”.*

Pjesëmarrja e inxhinierëve dhe arkitektëve, nuk e bën aktivitetin publik nga natyra, por takimi në një tryezë me dyer të mbyllura, me natyrë teknike përkon me përmbushjen e detyrave funksionale të kryetarit të bashkisë.

Përsa më sipër, në kushtet ku referuar elementeve të këtij aktivitetit, subjekti bashkia Lezhë nuk ka patur detyrimin e raportimit të këtij aktiviteti në kuptim të nenit nenit 92 të Kodit Zgjedhor, vlerësohet se duhet të pushohet shqyrtimi administrativ.

4. Denoncimi regjistruar me nr. 401 ID ndaj Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me kërkues KRIIK, ku pretendohet si më poshtë vijon:

- **Denoncimi nr. 401 ID:** *"Bashkë me Belinda Balluku pamë nga afër një tjetër investim transformues për shëndetësinë në #Dibër që është drejt përfundimit. Poliklinika e re e qytetit, teksa bëhemi gati për super investimin në Spitalin Rajonal Dibër, investim që do të garantojë cilësinë më të mirë të shërbimit për qytetarët e të gjithë qarkut.*

#Mirënjohje për punën dhe përkushtimin e stafit mjekësor të këtij spitali, të mjekëve të Peshkopisë por edhe ekipit të ri të mjekëve që ka ardhur nga Tirana, të cilët po bëjnë një punë të lavdërueshme, duke plotësuar më së miri skuadrën fantastike të spitalit të Dibrës.

#Respekt

Prova link:

<https://www.facebook.com/OgertaManastirliu/posts/pfbid0MTc3iVSPJt7vvhS71xP3oVBb3J3AsxJfoDbvVQëPBPHLoZqSjG9T6fGZJC7T8H5I>

<https://www.facebook.com/bballuku/posts/pfbid0qJVfFLho7LDXEsGH4Lx9ovi1c5iTb7iëNNqiQSQU39Db5kJ6rRAf7eMEszJggRmUI>

Theksohet se ky aktivitet nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator."

Më datë 8.5.2023, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike, ku institucioni ka sqaruar se *"...në vijim angazhimit për raportimin në kohë dhe shterues të të gjitha aktiviteteve me karakter publik në përputhje me Nenin 91 dhe 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, i ndryshuar si dhe Vendimit nr. 9 datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, duke qenë se faqja elektronike e KQZ më datë 25.04.2023 ishte në proces mirëmbajtje, (prova bashkëlidhur), ka njoftuar KQZ nëpërmjet postës elektronike për aktivitetin publik për zhvillimin e aktivitetit më datë 30.4.2023. (Lutemi gjeni në forward më poshtë emailin dërguar KQZ, datë 25.4.2023)*

Data: 26.6.2023

Nr: 675

Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 398 ID, 399 ID, 400 ID, 401 ID, 440 ID, 441 ID për shkelje administrative"

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 11.5.2023, ora 12:00, ku u ftuan në këtë proces, duke u dhënë të drejtën për t'u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi.

Në seancë ishin të pranishëm përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të cilët konfirmuan edhe një herë për sa ishin shprehur në përgjigjen e tyre zyrtare. Ata deklaruan edhe një herë se raportimi i aktivitetit është bërë nëpërmjet email-it pasi ndërfaqja e raportimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve nuk mund të aksesohet për shkaqe teknike.

Nga verifikimi i të dhënave, fakteve dhe rrethanave të marra në shqyrtim nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve vlerësohet se problematikat me sistemin dhe vështirësitë për të aksesuar ndërfaqen e raportimeve ka ndodhur për shkaqe objektive jashtë vullnetit të organit publik.

Nga verifikimi i fakteve për sa më sipër, rezultoi se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ka raportuar kryerjen e aktivitetit objekt denoncimi, nëpërmjet postës elektronike.

Në këto kushte, duke qenë se qëllimi nuk ka qenë shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit, vlerësojmë se duhet mirëkuptuar situata e krijuar dhe të pushohet hetimi administrativ për ato shkelje që lidhen me çështjen objekt shqyrtimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se objekti rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndaj Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nuk përbën shkelje të nenit 92, Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe për rrjedhojë duhet pushuar shqyrtimi administrative.

5. Denoncimi regjistruar me nr. 440 ID ndaj Bashkisë Roskovec, me kërkues KRIIK, ku pretendohet si më poshtë vijon:

- **Denoncimi nr. 440 ID:** *“Së bashku me përfaqësues të shkollës së mesme “Rakip Kryeziu” dhe përfaqësues të ZVA-së zhvilluam panairin “Këshillimi dhe orientimi për karrierën” me nxënësit e shkollave 9- vjeçare të bashkisë Roskovec.*

Qëllimi i këtij takimi ishte informimi mbi programet e arsimit profesional, si një zgjedhje shumë e mirë për të ardhmen.

#BashkiaRoskovec #RakipKryeziu #Zva

Prova link:

Data: 26.6.2023

Nr: 675

Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 398 ID, 399 ID, 400 ID, 401 ID, 440 ID, 441 ID për shkelje administrative”

<https://www.facebook.com/bashkiaroskovec/posts/pfbid02kTHDffCaASpn9uKDTYXqjqlEYh713Bf8DJzsKspYDhXCLzTv9vFqjb9qJqFDt1rE1>

Theksohet se ky aktivitet nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator."

Më datë 18.5.2023, bashkisë Roskovec dhe Zyrës Vendore Arsimore Roskovec, i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike.

Më datë 22.5.2023 bashkia Roskovec ka sqaruar se "...Ky aktivitet, konkretisht panairi "Këshillimi dhe orientimi për karrierën" me nxënësit e shkollave 9-vjeçare të bashkisë Roskovec është organizuar nga shkolla e mesme "Rakip Kryeziu", ditën e martë, datë 9.5.2023, ora 11:00, në sheshin qendror të bashkisë Roskovec, në Roskovec. Bashkia Roskovec ka qenë e ftuar në këtë aktivitet dhe pjesëmarrës ishin përfaqësues të shkollës së mesme Rakip Kryeziu, nxënës të shkollave 9-vjeçare të Bashkisë Roskovec të shoqëruar nga mësuesit, përfaqësues të Zyrës Vendore Arsimore Roskovec.

Qëllimi i aktivitetit ishte informimi mbi programet e arsimit profesional, si një zgjedhje shumë e mirë për të ardhmen për nxënësit e shkollave 9-vjeçare, konkretisht nxënësit e klasave të 9-ta që përfundojnë arsimin 9-vjeçar dhe në shtator fillojnë arsimin e mesëm.

Nga ana e bashkisë Roskovec pjesëmarrëse ishte kryetarja e bashkisë zj. Majlinda Bufi, përgjegjësjë e sektorit të arsimit zj. Ervisa Baxhia.

Bashkëlidhur po ju vemë në dispozicion printscreen të email-it të ardhur nga shkolla "Rakip Kryeziu", "Kërkesë për bashkëpunim".

Nga verifikimi i të dhënave, fakteve dhe rrethanave të marra në shqyrtim nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve rezultoi se bashkia Roskovec nuk ka qenë organizatore e këtij aktiviteti, por ka qenë pjesëmarrëse në cilësinë e bashkëpunëtorit dhe për pasojë nuk ka patur detyrimin për të raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në respektim të nenit 92 të Kodit Zgjedhor. Në mbështetje të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, veprimtaria e zhvilluar përbën veprimtari publike dhe për pasojë mbi të rëndon detyrimi për tu raportuar brenda afateve ligjore.

Po ashtu, pasi shqyrtova të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, vlerësoj se për të dhënat që disponohen, të nisur nga tematika dhe natyra e aktivitetit, është vlerësuar se veprimtaritë e kryera nga subjekti i denoncuar nuk përbëjnë veprimtari publike në kuptim të pikës 1, të nenit 92 të Kodit Zgjedhor.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se objekti rast hetimi pranë Komisionit

Data: 26.6.2023

Nr: 675

Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 398 ID, 399 ID, 400 ID, 401 ID, 440 ID, 441 ID për shkelje administrative"

Qendror të Zgjedhjeve ndaj bashkisë Roskovec, nuk përbën shkelje të nenit 92, Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe për rrjedhojë duhet pushuar shqyrtimi administrative.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

V E N D O S:

1. Moskonstatimin e shkeljes dhe pushimin e shqyrtimit administrativ ndaj:
 - Z. Ditmir Kraja, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Shkodër;
 - Zj. Xheni Kitaj, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Korçë;
 - Z. Reinis Çela, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Lezhë;
 - Zj. Alma Dervishi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
 - Zj. Delina Hoxha, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Roskovec;
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 26.6.2023

Nr: 675
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 398 ID, 399 ID, 400 ID, 401 ID, 440 ID, 441 ID për shkelje administrative”